



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 443 Prot.

Tiranë, më 14 / 4 /2017

VENDIM
“Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 62, datë 14 / 4 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr.443 Prot. datë 10.03.2017 me objekt, “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare” ndaj Autoritetit Publik “Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Me datë 22.02.2017, ankuesi ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion, me objekt si më poshtë:

- *Cilat janë masat praktike të marra, për bërjen publike të të gjitha dokumenteve arkivore që dëshmojnë krimet e kryera nga regjimi komunist dhe ato të kryera nga ky regjim kundër klerit, në zbatim të plotë të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë;*
- *Kopje të plan veprimit të Autoritetit, për zbatimin e menjëhershëm të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga kjo rezolutë.*

Ankuesi pretendon se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar për të gjitha pikat e kërkesës dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, në zbatim të nenit 24, pika 3 e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me urdhrin nr. 82 Prot. datë 23.03.2017, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, sqaruan se nuk e disponojnë informacionin e kërkuar. Duke qenë se ky është një institucion i ri i krijuar rishtazi, nuk janë krijuar ende strukturat përkatëse dhe për këtë arsye nuk është bërë e mundur të koordinohet puna për të kthyer përgjigje brenda afatit ligjor.

Gjithashtu përfaqësuesit e Autoritetit Publik u shprehën se rezervojnë të drejtën për të kthyer përgjigje kërkuarit brenda datës 29.03.2017.

Me e-mail-in e datës 27.03.2017, Autoriteti Publik ka informuar kërkuarin se informacioni i kërkuar nuk administrohet nga Autoriteti Publik dhe për këtë arsye nuk mund t'i vihet në dispozicion.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e Z. _____ ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ajo rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën e) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 443 Prot., datë 10.03.2017 të Z. _____ kundër Autoritetit Publik/Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit.
2. Kundër vendimit, ankuesi ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u dha sot me datë 14 . 4 .2017.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
